



**NJOFTIM**  
**PËR POZICION TË LIRË PUNE**  
**PËRGJEGJËS SEKTORI NË SEKTORIN E ZHVILLIMEVE DIGJITALE NË DREJTORINË E LOGJISTIKËS DHE**  
**DIGJITALIZIMIT**

**LËVIZJA PARALELE BRENDË TË NJËTËS KATEGORI**

Në mbështetje të nenit 26, Kreut V të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 242, të Këshillit të Ministrave datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, kreu II, “Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njofton se:

Në Administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka 1 (një) vend të lirë pune, për nëpunës civil të kategorisë së ulët drejtuese. Kategoria e pagës III-1.

**Lëvizje Paralele**

Pozicioni u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se pozicioni, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës “Ngritja në detyrë”.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËTËN KOHË.**

<b>Afati për dorëzimin e dokumentave:</b>	<b>15.02.2024</b>
---	-------------------

**Për lëvizje paralele**

<b>Afati për dorëzimin e dokumentave:</b>	<b>20.02.2024</b>
---	-------------------

**Për ngritje në detyrë**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:**

1. Të përgjigjet për funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e të gjithë pajisjeve elektronike të KQZ.
2. Të përgjigjet për funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të KQZ, sistemeve të shfrytëzimit të aplikacioneve në të gjithë kompjuterët e punonjësve të KQZ-së.
3. Të përgjigjet për administrimin dhe skanimin e formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputetë, kryetar bashkie dhe anëtarë këshillash bashkiakë.
4. Të përgjigjet për mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes zyrtare dhe platformave të KQZ në web si dhe rifreskimin periodik të tyre.
5. Të përgjigjet për mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrjetit dhe sistemeve që administron.
6. Të ndjekë veprimtarinë e Qendrës së Ndhmës gjatë fushatës zgjedhore.

7. Të menaxhojë projektin për votimin dhe numërimin elektronik dhe propozon përmirësime në vijimësi.

**Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:**

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën dy vlerësimet e fundit “mirë” ose “shumë mirë”.
4. Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim.

**Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:**

**Arsimi:** I lartë, master shkencor, në degët elektronike, informatikë ose shkencat kompjuterike.

**Përvoja:** Të ketë përvojë pune jo më pak se 2 (dy) vjet në nivel të ulët drejtues.

1. Veprimtari të shkëlqyera të realizimit të projekteve të ngjashme me detyrat funksionale.
2. Të ketë njohuri të gjera në fushën e IT-së, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon drejtoria, njohuri shumë të mira të procedurave administrative, profesionale, aftësi për të përcaktuar objektiva dhe vendosur prioritete dhe respektuar afatet, aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe koordinuar punën e stafit në vartësi, aftësi të mira komunikimi.
3. Të zotërojë një gjuhë të BE, avantazh anglisht.

**Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit të KQZ-së, dokumentet e dosjes së tij personale.**

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit.
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Edukimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën të notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
7. Aktin e emërimit si nëpunës civil.
8. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
9. Fotokopje librezës së punës.
10. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
11. Fotokopje të kartës së identitetit.
12. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
13. Vërtetim i gjendjes shëndetsore.

**KY DOKUMENTACION DUHET TË DORËZOHET NGA KANDIDATI BRENDË 10 (DHJETË) DITË KALENDARIKE NGA MOMENTI I SHPALLJES NË PORTAL.**

## Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi dhe intervista

1. Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Njohuri mbi ligjin nr.10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. Njohuri mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
4. Njohuri mbi ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
5. Njohuri mbi vendimin nr. 945, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”;
6. Njohuri mbi legjisllacionin për krimin kibernetik: [www.akshi.gov.al/Legjisllacioni](http://www.akshi.gov.al/Legjisllacioni);
7. Njohuri mbi Standardet Teknike të Publikimit të të Dhënave në Formatin Open Data;
8. Njohuri mbi rregulloren për afrimin e shërbimeve të përqendruara elektronike në administratën publike;
9. Njohuri mbi vendimin nr. 710 datë 21.08.2013 të Këshillit të Ministrave "Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmerisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Rezultatet për verifikimin paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datën **19.02.2024**, nëpërmjet shpalljes së listës emërore të verifikimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të KQZ-së.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

**INTERVISTA ME GOJË DO TË ZHVILLOHET NË AMBIENTET E KQZ-SË NË DATËN 28.02.2024, ORA 10:00.**

### Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3(tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3(tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

**KANDIDATI FITUES DO TË SHPALLET NGA NJËSIA PËRGJEGJËSE NË PORTALIN “SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT”, SI DHE NË FAQEN ZYRTARE TË KQZ-SË.**

## **Ngritja në Detyrë**

Në mbështetje të nenit 26, Kreut V të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, vendimit nr. 242, të Këshillit të Ministrave datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Kreu III, "Ngritja në Detyrë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njofton se:

Në Administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka 1 (një) vend të lirë pune, për nëpunës civil të kategorisë së ulët drejtuese. Kategoria e pagës III-1.

### **Konkursi do të kalojë në këto faza:**

- Faza e parë;
  - a) Verifikimi i kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit.
- Faza e dytë;
  - a) Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën.
  - b) Vlerësimi me shkrim.
  - c) Intervista e strukturuar me gojë.

### **Kërkesat e përgjithshme për këtë vend pune janë:**

- 1) Të jetë shtetas shqiptar.
- 2) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- 3) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- 4) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- 5) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, që nuk është shuar sipas këtij ligji.
- 6) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

### **Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:**

**Arsimi:** I lartë, master shkencor, në degët elektronike, informatikë ose shkencat kompjuterike.

**Përvoja:** Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 (tre) vjet në profesion.

1. Veprimtari të shkëlqyera të realizimit të projekteve të ngjashme me detyrat funksionale.
2. Të ketë njohuri të gjera në fushën e IT-së, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon drejtoria, njohuri shumë të mira të procedurave administrative, profesionale, aftësi për të përcaktuar objektiva dhe vendosur prioritete dhe respektuar afatet, aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe koordinuar punën e stafit në vartësi, aftësi të mira komunikimi.
3. Të zotërojë një gjuhë të BE, avantazh anglisht.

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:**

1. Të përgjigjet për funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e te gjithë pajisjeve elektronike të KQZ.
2. Të përgjigjet për funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të KQZ, sistemeve të shfrytëzimit të aplikacioneve në të gjithë kompjuterët e punonjësve të KQZ-së.
3. Të përgjigjet për administrimin dhe skanimin e formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputetë, kryetar bashkie dhe anëtarë këshillash bashkiakë.
4. Të përgjigjet për mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes zyrtare dhe platformave te KQZ ne web si dhe rifreskimin periodik te tyre.
5. Të përgjigjet për mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrjetit dhe sistemeve që administron.
6. Të ndjekë veprimtarinë e Qendrës së Ndihmës gjatë fushatës zgjedhore.
7. Të menaxhojë projektin për votimin dhe numërimin elektronik dhe propozon përmirësime në vijimësi.

**Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit të KQZ-së, këto dokumenta:**

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje të jetëshkrimit;
3. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
4. Fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
5. Fotokopje e diplomës me listën të notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
6. Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
7. Aktin e emërimit si nëpunës civil.
8. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi;
9. Fotokopje librezës së punës;
10. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
11. Fotokopje të kartës së identitetit;
12. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
13. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.

**PRANIMI I DOKUMENTEVE DO TË BËHET, JO MË PAK SE 15 (PESËMBËDHJETË) DITË KALENDARIKE.**

Në datën **28.02.2024**, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KQZ-së.

Ankesat nga kandidatët që nuk janë kualifikuar paraqesin ankesë me shkrim pranë Njësisë përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

**Mënyra e vlerësimit të Kandidatëve;**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND)** i ngritur pranë institucionit të KQZ-së.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar (ekperience, trajnime, kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, si dhe 2 vlerësimet e fundit pozitive);
- b) 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c) 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Njësia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij.

Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në (KPND) për rezultatin e pikëve brenda 3(tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

**SHPLLJA E FITUESIT/ FITUESVE BËHET NË FAQEN ZYRTARE TË KQZ-SË DHE NË PORTALIN; “SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT”.**

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.4, Tiranë, si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

**Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**